



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 129, Datë 27.05.2021

MBI

**MOS FILLIMIN E PROCEDURËS PËR TRANSFERIMIN E LICENCËS SË
VEPRIMTARISË SË PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE PËR HEC-ET
LUSEN 1, 2, 3, NGA SHOQËRIA “EUROBIZNES” SH.P.K., TEK SHOQËRIA “ETE-
GRUP-TEKNOLOGJI” SH.P.K.**

Në mbështetje të nenit 16 dhe 44, pika 1, të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar; nenit 10, pikat 1 dhe 3, dhe nenit 17, të Rregullores për Procedurat dhe Afatet për dhënie, Modifikimi, Transferimi, Rinovimi ose Heqjen e Licencave në Sektorin e Energjisë Elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr.109, datë 29.06.2016, miratuar ndryshimet me vendimin e bordit të ERE nr.215/2019 dhe nenit 19, pika 1, gërma “a”, të “Rregullave për Organizimin, Funksonimin dhe Procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96 datë 17 .06.2017, bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 27.05.2021, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 76/3 prot., datë 24.05.2021, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, për “Mos fillimin e procedurës për transferimin e licencës së veprimitarisë së prodhimit të energjisë elektrike për HEC-et Lusen 1, 2, 3 nga shoqëria “EUROBIZNES” sh.p.k., tek shoqëria “ETE-GRUP-TEKNOLOGJI” sh.p.k.”,

Konstatoi se:

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 675 prot., datë 18.05.2021, shoqëritë “EUROBIZNES” sh.p.k. dhe “ETE-GRUP-TEKNOLOGJI” sh.p.k., në cilësinë e bashkimit të përkohshëm të shoqërive, bashkim ky me shoqëri kryesuese “EUROBIZNES” sh.p.k. (pajisur nga ERE me licencën e prodhimit të energjisë elektrike nr. 385, Seria PV17K), kanë paraqitur kërkesën për transferimin e licencës së prodhimit të energjisë elektrike për HEC-et Lusen 1, 2, 3, nga shoqëria “EUROBIZNES” sh.p.k., tek shoqëria “ETE-GRUP-TEKNOLOGJI” sh.p.k.
- Kërkesa për transferimin e licencës nga shoqëria “EUROBIZNES” sh.p.k., tek shoqëria “ETE-GRUP-TEKNOLOGJI” sh.p.k., vjen për arsye se shoqëria “EUROBIZNES” sh.p.k. ushtron aktivitete të tjera tregtare dhe shoqëria “ETE-GRUP-TEKNOLOGJI” sh.p.k. nuk do të ushtrojë aktivitetet tjetër përveç prodhimit të energjisë elektrike.
- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) me shkresën nr. 891/2 prot., datë 23.03.2021, shprehet se: “...konstatojmë se licenca në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et Lusen 1, 2, 3 është lëshuar në emër të njërit prej anëtarëve të Bashkimit të Përkohshëm të Shoqërive “EUROBIZNES” sh.p.k. dhe “ETE-GRUP-TEKNOLOGJI” sh.p.k., Për sa më sipër ju informojmë se MIE nuk mund të shprehet lidhur me ndryshimin e mbajtësit të licencës në aktivitetin e

prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et Lusën 1, 2, 3, nuk është parashikuar miratimi nga ana e MIE për zëvendësimin e kërkuar nga ana juaj”.

- Në ekstraktin e Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) rezulton se, shoqëria “ETE-GRUP-TEKNOLOGJI” sh.p.k., në objektin e veprimtarisë së saj ka edhe aktivitete të tjera përveç atij të prodhimit të energjisë elektrike. Pra, sa pasqyruar në QKB bindesh me sa deklaruar vetë nga shoqëria e cila thotë se nuk do të ushtrojë aktivitet tjetër përveç atij të prodhimit të energjisë elektrike. Përveç sa më sipër, nga QKB-ja rezulton se shoqëria “ETE-GRUP-TEKNOLOGJI” sh.p.k., është me status “Pezulluar”.
- Evidentohet se nuk është kryer pagesa e aplikimit në llogari të ERE-s për transferimin e licencës së prodhimit të energjisë elektrike, në zbatim të nenit 8, pika 2, i cili citon se: *“Aplikuesi duhet të kryejë pagesën për aplikim në momentin e paraqitjes së aplikimit, përcaktuar në aneksin - A- të kësaj rregulloreje”,* dhe si e tillë dokumentacioni i depozituar si me poshte nuk merret në shqyrtim nga ERE:
 - Marrëveshje midis shoqërive “EUROBIZNES” sh.p.k., dhe “ETE-GRUP-TEKNOLOGJI” sh.p.k.;
 - Vendimi i Asamblesë së Ortakëve të shoqërisë “EUROBIZNES” sh.p.k., datë 10.05.2021;
 - Vendim i Ortakut të vetëm të shoqërisë “ETE-GRUP-TEKNOLOGJI” sh.p.k.;
 - Informacion në lidhje me transferimin e licencës së ERE-s dhe Formatit i Aplikimit të shoqërisë “ETE-GRUP-TEKNOLOGJI” sh.p.k.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të mos fillojë procedurën për transferimin e licencës nr. 385, Seria PV17K në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike për HEC-et Lusën 1, 2, 3 nga shoqëria “EUROBIZNES” sh.p.k., tek shoqëria “ETE-GRUP-TEKNOLOGJI” sh.p.k.
2. Drejtorja e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë shoqëritë për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE
Petrit AHMETI